



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më, 22.10.2018

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ZYRËS SË POLICISË EVROPIANE (EUROPOL), PËR BASHKËPUNIMIN E
ZBATIMIT TË LIGJIT, MBI VENDOSJEN E OFICERIT NDËRLIDHËS TË EUROPOL-
IT”**

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.10.2018 shqyrtoi projektligjin, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, Z. Besfort Lamellari, Zv.Ministër i Brendshëm, Kryekomisar Shkëlzen Rexhepi, Shefi i Zyrës Kombëtare të EUROPOL-it dhe Z. Jeton Xoxa, Specialist i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave në Ministrinë e Brendshme.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të EUROPOL-it”, ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjensisë së Bashkimit Evropian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të EUROPOL-it, e cila është miratuar në parim me vendimin nr. 403, datë 04.07.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar nga palët.

Marrëveshja synon vendosjen e oficerit ndërlidhës të Agjensisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit (EUROPOL) në vendin tonë.

Kjo marrëveshje synon të sjellë mbështetje, bashkërendim të veprimeve dhe bashkëpunim në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar, si dhe lehtësim të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, EUROPOL-it dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Në marrëveshje parashikohen qartë detyrat, statusi i oficerit ose oficerëve ndërlidhës, metodat e punës, çështjet administrative, mënyra për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rast konflikti dhe modalitete të tjera.

Efekte financiare

Shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes, të cilat parashikohen në nenin 5/1 të marrëveshjes do të mbulohen nga buxheti i policisë së shtetit, ndërsa kostot e telekomunikacionit do të mbulohen nga EUROPOL-i.

Diskutimet në Komision

Pas prezantimit të projektligjit dhe sqarimeve të nevojshme nga pala e ftuar, komisioni votoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL), për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të EUROPOL-it” është propozim i ardhur nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 78 dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 68, të Rregullores së Kuvendit si dhe në përmbushje të nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI